

Lënda: Kthim përgjigje

Znj. Ana Sema

Në përgjigje të kërkesës tuaj, me nr. 8614 prot, datë 19.10.2023, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, në të cilën kërkonti verifikimin e vjetërsisë në punë për efekt dokumentacioni jashtë shtetit, në emër të babait tuaj Gjergji Sotir Sema, i cili ka ndërruar jetë, ju bëjmë me dije se:

Instituti i Sigurimeve Shoqërore në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 29.04.2022 “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbimofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”, duke filluar nga data 1.05.2022, ofron shërbimet bazuar në kërkesat e përfituesve, të cilat paraqiten on-line nëpërmjet platformës e-Albania.

Në zbatim të VKM-së nr. 252, datë 29.4.2022, për verifikimin e periudhave të vjetërsisë në punë/sigurimit, në varësi të periudha të punës që babai juaj ka realizuar deri në momentin që ka ndërruar jetë, duhet të aplikoni nëpërmjet llogarisë tuaj, në portalin e-Albania tek shërbimet si më poshtë:

- “Vërtetim për periudha pune në ish - kooperativa bujqësore (KB) ”. Ky shërbim u mundëson qytetarëve të marrin online vërtetimin për periudhat e punës në Kooperativat Bujqësore.
- “Vërtetim për periudha pune në ndërmarrje shtetërore para datës 01.01.1994”. Ky shërbim u mundëson qytetarëve të marrin online vërtetimin për periudhat e punës në ndërmarrje shtetërore para datës 01.01.1994.
- “Vërtetim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore nga 01.01.1994 deri 31.12.2011”. Ky shërbim u mundëson qytetarëve të marrin online vërtetimin për periudhat e punës për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore si i punësuar, pas datës 01.01.1994.
- “Vërtetim i pagesës së kontributeve të të vetëpunësuarve në bujqësi 1993-2013”. Ky shërbim u mundëson qytetarëve të marrin online vërtetimin për pagesën e kontributeve të të vetëpunësuarve në bujqësi .

- “Vërtetim i pagesës së kontributeve vullnetare”. Ky shërbim i ofrohet çdo personi që ka bërë sigurim vullnetar, për përfitim nga ligji i sigurimeve shoqërore për pensione.
- “Vërtetim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore pas datës 01.01.2012”. Ky shërbim u mundëson qytetarëve të marrin online vërtetimin për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore me vulë elektronike me vlerë të plotë ligjore.

Aplikimet duhet t’ja adresoni Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, në të cilën kanë zhvilluar aktivitetin ekonomik, subjektet ku ka punuar babai juaj.

Në në rubrikën shënime, të aplikimit duhet të specifikoni se, periudhat e vjetërsi në punë i kërkoni në emër të babait tuaj, z. Gjergji Sotir Sema, i datëlindjes 01.10.1964, i cili ka ndërruar jetë, për efekt dokumentacioni jashtë shtetit.

Ndërsa në seksionin III, të aplikimit, në rubrikën “Dokumente që ngarkohen nga aplikanti” duhet të ngarkoni kopjen e librezës së tij të punës dhe një certifikatë familjare për të vërtetuar lidhjen me të ndjerin, të cilat duhet ti keni skanuar paraprakisht,

Struktura rajonale të sigurimeve shoqërore pasi të marrin në shqyrtim aplikimet tuaj, do të kryejnë verifikimet përkatëse dhe do t’ju kthejë përgjigje brenda afateve zyrtare, nëpërmjet portalit e-Albania, në rubrikën “Dokumentat e mia”.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.